

PROGRAMI I SHKËMBIMIT TË OJF-VE



© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.
Tiranë, Shqipëri 2023

Kontakt:



www.partnersalbania.org



partners@partnersalbania.org



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Ky publikim u bë i mundur falë mbështetjes financiare të Ambasadës së SHBA-së në Tiranë. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës së SHBA-së në Tiranë.

PROGRAMI I SHKËMBIMIT TË OJF-VE

“Programi i Shkëmbimit të OJF-ve” është një nga nismat më të reja të ndërmarra nga Partnerët Shqipëri, e cila vjen në vijim të punës disa vjeçare në mbështetje të fuqizimit të sektorit të OJF-ve, në ndërtimin e dialogut ndërsektorial për përfshirjen e OJF-ve në politikëbërje dhe procese vendimmarrëse.

Programi kontribuon në rritjen e kapaciteteve të organizatave të reja, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qytete të ndryshme në mbarë vendin, duke mundësuar rritjen e aksesit në informacion dhe bashkëpunimin me organizata të tjera dhe institucione të rëndësishme në vend.

Pjesëmarrësit në program përzgjidhen përmes një thirrje të hapur për shprehje interesi. Programi është një kombinim i vizitave në organizata, institucione publike dhe private, sesioneve të diskutimit me ekspertë të fushave të ndryshme, si dhe seancave të mentorimit për vënien në praktikë të njohurive të fituara.

Kjo broshurë paraqet një seri dëshmish të pjesëmarrësve në dy programet e para të organizuara gjatë vitit 2023. Në vijim Partnerët Shqipëri planifikon organizimin e të tjera programeve, si pjesë e një ndërhyrjeje afatgjatë në ndihmë të sektorit.

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDËRYSHMË DHE ZHVILLIM

THIRRJE PËR SHPREHJE
INTERESI

**PROGRAMI I
SHKËMBIMIT
TË OJF-VE**



Vizito faqen tonë të Internetit
www.partnersalbania.org



APLIKO TANI !



Programi i Shkëmbimit të OJF-ve

Apliko tani

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDËRYSHMË DHE ZHVILLIM





29



përfaqësues
të 22 OJF-ve
në 15 qytete




2
programe



56
sesione
mentorimi





Raundi 1

PJESËMARRËSIT	ORGANIZATA	QYTETI
Abdyl Arifaj	Shoqata Apiterapia Shqiptare	Tiranë
Arbërora Leti	Opportunity, Balance & Overcoming	Rrëshen
Ardiola Alikaj	Visit Saranda	Sarandë
Arnisa Xhaferi	Qendra e Gruas - "Hapa të Lehtë"	Shkodër
Bleona Kadana	Qendra Rinore Pukë	Pukë
Donika Marashi	Komuniteti Papa Xhovani XXIII	Shkodër
Klaudio Hyseni	Qendra Durrësi Aktiv	Durrës
Meliha Zyberaj	Artizanët e Vaut Dejës	Vau Dejës
Mira Prekperaj	Komuniteti Papa Xhovani XXIII	Shkodër
Sara Marku	Pranë Teje	Lezhë
Shaqir Jugu	Soek-In	Librazhd
Valbona Lluca	Artizanët e Vaut Dejës	Vau Dejës

Raundi 2

Aishe Tufa	Rural Voice	Bulqizë
Arjola Bajramaj	Gjelbërimi 2000	Vlorë
Bruna Flamuraj	Dorcas Aid International Albania	Korçë
Bruna Gerveshi	Shoqata "MKEZH"	Gjirokastrë
Dentila Garipi	Lunah - Qendër Edukimi	Durrës
Elda Vendresha	Lunah - Qendër Edukimi	Durrës
Emand Agolli	Kujdestari i Fëmijëve	Pogradec
Ervin Dallaku	Fondacioni Misioni Emanuel	Korçë
Ilda Mitre	Fondacioni Misioni Emanuel	Korçë
Kristina Gjinaj	Shoqata "Në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë"	Fushë-Arrëz
Nordana Hasa	Horizont Sërisht	Shkodër
Marinela Sela	Horizont Sërisht	Shkodër
Oliana Manaj	Qendra psiko-sociale "Vatra"	Vlorë
Paola Qafa	Shoqata "Në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë"	Fushë-Arrëz
Pranvera Dhima	Shtegu i Shpresës	Tiranë
Sali Xhaferri	Rural Voice	Bulqizë
Xhensila Mirashi	Act Think Center	Korçë



DËSHMI

TË PËRFAQËSUESVE TË OJF-VE, PËRFITUES TË PROGRAMIT

ARMIR KHAFAJ

ERMONELA



Oliana Manaj

Përhëndetje! Unë quhem Oliana Manaj dhe përfaqësoj "Qendrën Psiko-Sociale Vatra" në qytetin e Vlorës. Kam pasur nderin të bëhem pjesë e "Programit të Shkëmbimit të OJF-ve" të organizuar nga Partnerët Shqipëri. Këtë program e quaj frymëzues dhe të rëndësishëm, duke qenë se u njoha me aktivistë të rinj dhe organizata të reja që operojnë në Shqipëri, të cilët janë burim frymëzimi për punën që bëjnë për vendin tonë. Po ashtu, vizitat në institucione dhe organizata të tjera të shoqërisë civile më ndihmuan të kuptoj më shumë punën që bëhet me problematikat e ndryshme të shoqërisë shqiptare. Me plot bindje, do t'i rekomandoja të gjithë organizatat e ngjashme të jenë pjesë e këtij programi shkëmbimi. Do të kenë mundësi të njiheni me njerëz të rinj, të mësoni më shumë për punën e institucioneve dhe të ndani eksperiencat dhe praktikat më të mira. Faleminderit!



Kristina Gjinaj

Përhëndetje! Unë quhem Kristina Gjinaj, pjesë e shoqatës "Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë". Jam shumë e lumtur që kam qenë pjesë e këtyre takimeve të shkëmbimit të eksperiencave, pasi gjatë tyre kam njohur organizata potenciale për të bashkëpunuar në të ardhmen. Gjithashtu, jam njohur me mundësi të mbështetjes me grante për projekte të reja. Pata mundësinë të jem edhe në Kuvendin e Shqipërisë për të takuar përfaqësues të rëndësishëm duke mundësuar prezantimin e organizatës sime dhe eksplorimin e parteriteteve për të ardhmen. Shpresoj gjithashtu të marrim pjesë edhe në proceset konsultuese për ligje të ndryshme, që Kuvendi i Shqipërisë do të organizojë në të ardhmen. Faleminderit!



Aisha Tufa

Përshëndetje! Jam Aisha Tufa nga Bulqiza. Në "Programin e Shkëmbimit të OJF-ve" të organizuar nga Partnerët Shqipëri kam marrë pjesë si përfaqësuese e shoqatës "Rural Voice", një shoqatë e re që ka në fokus kryesisht mjedisin. Gjatë katër ditëve të programit jemi njohur nga afër me shumë institucione dhe shoqata të tjera dhe bashkëbisedimi me ta ka qenë shumë i frytshëm. Mund të them që është një nga programet më reale dhe më praktikë ku unë kam marrë pjesë. Pjesëmarrjen në këtë program ua sygjeroj çdo shoqate të re që është në fillimet e punës së saj. Jam shumë e lumtur që isha pjesë e programit. Faleminderit!



Pranvera Dhima

Përshëndetje! Unë jam Pranvera Dhima, Drejtore Ekzekutive e fondacionit "Shtegu i Shpresës", qendër këshillimit dhe terapie për fëmijë e të rritur që ofron shërbimet e saj në Tiranë. Për herë të parë këtë vit jam bërë pjesë e programit të organizuar nga Partnerët Shqipëri, program në të cilin pata mundësi të njihem me kolegë, me profesionistë, me drejtues dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme, pjesë të shoqërisë civile, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në gjithë territorin e Shqipërisë. Për ne bashkëpunimi me organizata të tjera është shumë i rëndësishëm, sepse vetëm mund të bëjmë disa punë, por së bashku mund të bëjmë akoma dhe më tepër. Në këtë program patëm mundësinë që të njihemi me institucione që mbështesin shoqërinë civile, por jo vetëm kaq, gjithashtu dhe me mënyra të financimit të organizatave të cilat ne drejtojmë. Është e rëndësishme të jemi pjesë e një ombrelle më të madhe, dhe Partnerët Shqipëri bën një punë të shkëlqyer për krijimin e mundësive për rrjetëzimin e OJF-të në mbarë vendin. Programin do ta sugjeroja për secilin prej jush që po e konsideron pjesëmarrjen. Koha e investuar në program ka vlerën e saj.



Ilda Mitre

Unë jam Ilda, punoj pranë "Fondacionit Misioni Emanuel", që ka selinë në qytetin e Korçës. Dua të theksoj që përvoja në këtë program të shkëmbimit të eksperiencave ka qenë e jashtëzakonshme për mua. Ka pasur një ndikim pozitiv të madh në zhvillimin tim personal dhe besoj, do të kontribuojë gjithashtu në zhvillimin e organizatës sime. Kjo më ka lejuar të njoh shumë institucione dhe organizata, dhe kam pasur rastin të mësoj më shumë rreth tyre dhe punës së tyre. Mendoj se kjo përvojë është e vlefshme për çdo organizatë dhe e rekomandoj me këmbëngulje për të gjitha organizatat. Nëse Partnerët Shqipëri ka plane për të zhvilluar një program të ngjashëm në të ardhmen, inkurajoj të gjithë të marrin pjesë, pasi është një mundësi e shkëlqyer.



Bruna Flamuraj

Përhëndetje! Unë jam Bruna dhe përfaqësoj organizatën "Dorcas Aid International Albania". Falenderoj Partnerët Shqipëri, për këtë program të shkëmbimit të eksperiencave mes organizatave. Unë besoj se këto lloj shkëmbimesh duhen të ndodhin më shpesh, sepse ato na japin mundësinë të mësojmë nga praktikat më të mira të organizatave të tjera. Për mua, ky program ka qenë shumë i vlefshëm dhe shpresoj që do të ketë një ndikim pozitiv edhe në organizatën time. Faleminderit!



Ermand Agolli

Përshëndetje! Unë jam Ermand Agolli dhe vij nga qyteti i Pogradecit. Unë përfaqësoj "Fondacionin Kujdestar të Fëmijëve" që ndihmon fëmijët jetimë dhe ata në nevojë. Dua të falenderoj Partnerët Shqipëri për mbështetjen e jashtëzakonshme që na ka ofruar gjatë këtyre ditëve, duke na lejuar të takojmë shumë institucione dhe të gjejmë përkrahje nga shumë organizata, për projektet tona. Faleminderit shumë!



Bruna Gërveshti

Përshëndetje! Unë jam Bruna Gërveshti dhe vij nga Gjirokastra. Jam anëtare e shoqatës "Multifunkionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim" (MKEZH). Ky program më ka mundësuar të njihem me disa nga organizatat jofitimprurëse në Shqipëri, nga jugu në veri. Ai më ka ndihmuar të mësoj nga eksperiencat e tyre kryesisht në fushën e advokatisë në çështje të ndryshme dhe mënyrën si ato punojnë për të adresuar çështjet sociale. Gjithashtu, takimi me institucionet publike ka qenë një përvojë shumë frytdhënëse për mua, si individ dhe si pjesë e shoqatës. E rekomandoj këtë program me shumë entuziazëm, pasi më ka ndihmuar të rritem profesionalisht dhe personalisht.



Dentila Garipi

Përshëndetje. Unë jam Dentila Garipi, Drejtore Ekzekutive e qendrës "LUNAH - Qendër Edukimi", në qytetin e Durrësit. Programi i Shkëmbimit të OJF-ve, më ka vlejtur mua dhe kolegëve të mi në drejtim të zgjerimit të njohurive, zhvillimit profesional si dhe motivimit tonë. Kemi nisur të krijojmë rrjetin tonë të partnerëve, i cili për hir të së vërtetës një impakt shumë të madh e pati falë këtij programi. Unë jam falenderuese për OJF-të pritëse në këtë program, në emër të të gjithë pjesëtarëve të tjerë të qendrës sonë, dhe besoj se çdo organizatë tjetër e re si ne, duhet të angazhohet për t'i dhënë organizatave të tyre një qasje më bashkëkohore. Ju faleminderit Partnerët Shqipëri për këtë mundësi.



Elda Vendresha

Përshëndetje! Unë jam Elda Vendresha nga "LUNAH-Qendër Edukimi" dhe isha pjesë e këtij programi të zhvilluar nga Partnerët Shqipëri e cila kontribuon në zhvillimin e organizatave jofitimprurëse. Duke qenë se organizata jonë është e re, ky program ka qenë shumë frytdhënës për mua. Më ka ndihmuar të kuptoj më mirë se si duhet të funksionojë një organizatë jofitimprurëse. Gjithashtu, kemi patur rastin të bashkëpunojmë me shumë organizata të tjera që kanë qëllime të ngjashme. E rekomandoj këtë program me entuziazëm.



Sali Xhaferri

"Programi i Shkëmbimit të OJF-ve" është një mundësi shumë e mirë, veçanërisht për organizatat e reja si "Rural Voice". Nëpërmjet këtij programi, kemi krijuar lidhje të reja dhe bashkëpunime të rëndësishme. Gjithashtu, kemi njohur institucione private dhe publike që besoj do të na ndihmojnë në projektet tona të ardhshme.



Xhensila Mirashi

Në "Act Think Center", bashkëpunimi është kryefjala e punës sonë. Nga bashkëpunimi nuk del askush i humbur, përveçse i fituar. Ky program na dha mundësinë të zhvillojmë më tepër partneritetin me kolegët tanë të sektorit e jo vetëm. Shtrirja e rrjetit të bashkëpunorëve dhe eksperiencat që ndamë me njëri-tjetrin dhe me institucionet publike e pasuroi misionin e këtij aktiviteti. Jemi mirënjohës ndaj Partnerëve Shqipëri, për mundësinë e shkëlqyer që na ka dhënë pasi ndihemi më të fuqizuar për të adresuar kauzat tona, si dhe më produktiv pranë komunitetit që përfaqësojmë.



Ervin Dallaku

Përshëndetje! Unë quhem Ervin Dallaku dhe punoj pranë "Fondacionit Misioni Emanuel" në qytetin e Korçës. Për mua ka qenë vërtet një eksperiencë shumë e mirë pjesëmarrja në "Programin e Shkëmbimit të OJF-ve", organizuar nga Partnerët Shqipëri. Është një program i cili të jep mundësinë të njihesh me funksionet e institucioneve, dhe mundëson shkëmbimin e eksperiencave mes organizatave në qytete të ndryshme të vendit. Inkurajoj dhe sugjeroj organizatat jofitimprurëse të bëhen pjesë e këtij programi.



Klaudio Hyseni

Përshëndetje. Quhem Klaudio Hyseni, përfaqësoj qendrën "Durrësi Aktiv". Morëm pjesë në "Programin e Shkëmbimit të OJF-ve", i cili është shumë i vlefshëm për të gjitha organizatat. Gjatë këtij programi, vizitua institucione të pushtetit qendror, si dhe organizata me eksperiencë, që operojnë në qytetin e Tiranës. Ua rekomandoj organizatave të rretheve të aplikojnë në këtë program, sepse është e nevojshme për punën e tyre advokuese, si dhe për njohjen e organizatave dhe institucioneve të tjera. Bëhuni pjesë, është shumë i vlefshëm!



Arnisa Xhaferi

Përshëndetje! Unë jam Arnisa Xhaferi, jam juriste në Qendrën e Gruas - "Hapa të Lehtë", e cila operon në Shkodër. Kam aplikuar dhe u bëra pjesë e "Programit të Shkëmbimit të OJF-ve", i organizuar nga Partnerët Shqipëri. Gjatë gjithë trajnimit dhe eksperiencës në program, vlerësoj të gjitha informacionet që kemi marrë dhe diskutimet që kemi patur. Kemi diskutuar çështje si: financimi publik, njohja e standardeve të OJF-ve, rëndësia e pjesëmarrjes në rrjete, dhe shërbimet me pagesë në mbështetje të grupeve në nevojë. E shoh këtë si një mundësi shumë të mirë për veten time, por edhe për të rinjtë e tjerë. Është një ekspozim praktik i aktiviteteve të ndryshme të OJF-ve, që ndodhin jo vetëm në kryeqytet, por edhe në të gjitha rrethet e tjera të Shqipërisë.



Nordana Hasa

Përshëndetje! Quhem Nordana Hasa nga organizata "Sërisht Horizont", Shkodër. "Programi i Shkëmbimit të OJF-ve" ishte një eksperiencë shumë e vlefshme për mua personalisht, por edhe profesionalisht. Nuk e kisha njohur më parë këtë program. U njohëm me punën e institucioneve publike dhe organizatave me seli në Tiranë, mësuam disa modele mbi fushatat advokuese dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe pjesëmarrjen në proceset politikëbërëse. Ishte një eksperiencë mjaft e vyer për të krijuar parteritete midis pjesëmarrësve dhe institucioneve pritëse. Do ua rekomandoja edhe organizatave të tjera, pasi është eksperiencia e duhur për të bërë gjëra të mira në shërbim të komunitetit. Faleminderit!



Paola Qafa

Përsshëndetje! Unë jam Paola Qafa dhe vij nga shoqata "Qendra Sociale në Ndhimë të Njerëzve në Nevojë" (QSNNN) që operon në Fushë - Arrëz dhe ka për qëllim të mbrojtë moshën e tretë, mjedisin, si dhe shtresa të tjera në nevojë. Unë kam qenë vullnetare e kësaj shoqate për shumë vite, dhe kohët e fundit kam marrë përsipër manaxhimin e një projekti. Ky program ka qenë shumë i vlefshëm për mua, duke më mundësuar të njoh se si operon shoqëria civile në gjithë Shqipërinë. Kjo përvojë ka qenë shumë frymëzuese dhe më ka treguar se çfarë është e mundur të bëhet në këtë fushë. Edhe pse nuk kam përvojë të shumtë, kam kuptuar se çdo individ ka fuqinë të bëjë ndryshime në shoqëri. Faleminderit!



Sara Marku

Përsshëndetje! Jam Sara Marku nga Lezha, anëtare e shoqatës "Pranë Teje". "Programi i shkëmbimit të OJF-ve" ishte një program shumë i rëndësishëm për mua personalisht, por edhe shumë ndihmues dhe orientues për shoqatën ku bëj pjesë. Si një shoqatë e re, kjo përvojë na njohu me veprimtarinë dhe aktivitetet e shumë organizatave të shoqërisë civile, institucioneve dhe na ndihmoi për të krijuar mundësinë e një bashkëpunimi për të ardhmen. Përveç sektorit jofitimprurës, ne kemi pasur mundësinë, të njihemi edhe me institucionet qendrore dhe ftoj organizatat e reja, por jo vetëm, të marrin pjesë, pasi është një mënyrë mjaft e mirë për të zgjeruar rrjetin e tyre të bashkëpunorëve.

Arbërorra Leti

Përshëndetje! Unë jam Arbërorra, themeluese e organizatës "Opportunity, Balance & Overcoming", e cila operon në qytetin e Rëshenit. Në këtë program katër-ditor, vizituam disa institucione të pushtetit qendror dhe shoqërisë civile, ku mësuam teknika mbi advokimin, manaxhimin, administrimin dhe monitorimin e nismave tona. Këto teknika janë shumë të suksesshme për t'i implementuar në komunitetin tonë. Këtë program e rekomandoj për çdo organizatë, si një mundësi shumë të mirë për të zgjeruar rrjetin e saj, dhe për të mësuar mbi praktika të suksesshme të adresimit të nevojave të komunitetit. Përmes tij organizata jonë, falë njohjes dhe me Rrjetin "AWEN", u përzgjedh si organizatë fituese e një skeme financimi mbi parandalimin e diskriminimit direkt dhe indirekt të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Mirditë. I falenderoj për mundësinë dhe e rekomandoj këtë program për çdo organizatë që ka dëshirë dhe vullnet për të sjellë zhvillim dhe ndryshim pozitiv në komunitetin e saj.





KOMISIONI PËR ÇËKËJET LIGJËRE,
ADMINISTRATIVË PUBLIKË
DHE TË DREJTËSIAE

DËSHMI

TË PËRFAQËSUESVE TË INSTITUCIONEVE PRITËSE



15
institucione
pritëse



Lista e institucioneve pritëse

1. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)
2. Albanian Legal and Territorial Research Institute (Qendra A.L.T.R.I)
3. Avokati i Popullit
4. Balkan Investigative Reporting Network (BIRN Albania)
5. Banka Credins
6. Fondacioni Credins
7. FSHDPAK (Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar)
8. Instituti Parlamentar
9. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
10. Kuvendi i Shqipërisë
11. Nisma për Ndryshim Shoqëror – ARSIS
12. Qendra Jonathan
13. Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)
14. Roma Active Albania
15. Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)



LEFTERIJE LUZI

*Drejtores e Shërbimit të Komisioneve,
Kuvendi i Shqipërisë*



Institucioni i Kuvendit të Shqipërisë me shoqërinë civile dhe Partnerët Shqipëri ka patur bashkëpunime afatgjata të suksesshme. Si Drejtore e Shërbimit të Komisioneve në Kuvendin e Shqipërisë, ndaj mbështetjen time për nisma të tilla. Ky program shkëmbimi ofron një mundësi jo vetëm për OJF-të e reja, por edhe për ne si institucion pasi mblidhemi, diskutojmë, ndajmë informacion me njëri-tjetrin dhe bashkëpunojmë në nisma që kanë impakt, duke tejkaluar kufijtë gjeografikë dhe duke ndarë ekspertizën. Organizatat mund të përmirësojnë në mënyrë të konsiderueshme aftësinë e tyre për të ndikuar në jetën e grupeve dhe komuniteteve që u shërbejnë. Besoj se mbështetja e këtij programi përputhet me qëllimet tona të një institucioni të hapur dhe transparent por dhe nxitës i bashkëpunimit për të mirën publike.

“Programi i Shkëmbimit të OJF-ve” ishte shumë interesant dhe i bukur për fuqizimin dhe zhvillimin e shoqërisë civile. Partneriteti me shume institucione, prezantimet dhe bashkëpunimet mbi mundësitë e ofruara për OJF-të është një rast për tu vlerësuar. Kjo, duke konsideruar rëndësinë dhe impaktin e madh që ka shoqëria civile në zhvillimin e vendit. Banka Credins, si partnere e këtij programi, e cila ka shprehur gjithpërfshirjen e saj të plotë dhe në shumë aktivitete, ka patur kënaqësinë e veçantë të mirëpresës mbi 30 OJF pranë ambienteve të saj. Kemi patur kënaqësinë t'i informojmë mbi aktivitetet tona të përgjegjshisë korporative, si dhe prezantimin e platformës online Smile.al. Kjo është një mundësi dhe alternativë mjaft e mirë për këto OJF, për të prezantuar projektet/aktivitetet e tyre në këtë platformë, të cilat sigurisht ndihmojnë dhe krijojnë një impakt shumë të madh për zhvillimin, edukimin dhe rritjen e mirëqenies së shoqërisë shqiptare.



VALBONA GURI
*Drejtores Marketingu,
Banka Credins*

DËSHMI
TË PËRFAQËSUESVE TË
INSTITUCIONEVE PRITËSE

BLERJANA BINO

Drejtoreshë Ekzekutive, SCiDEV



Patëm kënaqësinë të presim në zyrat tona të SCiDEV, rreth 30 përfaqësues OJF-sh nga bashki të ndryshme të Shqipërisë si Durrësi, Saranda, Rrësheni, Shkodra, Librazhdi, Lezha, Puka, Vau Dejës, Bulqiza, Gjirokastra, Korça, Maliqi, dhe Pogradeci. Ky program ishte një mundësi e shkëlqyer për të ndarë përvojat dhe për të diskutuar thellësisht mbi aktivitetet tona në vazhdim. Këto vizita na ndihmuan të marrim një perspektivë më të gjerë mbi ndikimin e punës sonë, ndërsa gjithashtu na ofroi një mundësi për të dëgjuar dhe mësuar nga përvojat e OJF-ve të tjera. Ky ndërveprim është thelbësor për të na ndihmuar ne dhe partnerët tanë të forcojmë bashkëpunimin, të përmirësojmë dhe të zgjerojmë impaktin e punës sonë në shoqëri.

Për AWEN janë gjithmonë me vlerë dhe interes shkëmbime të kësaj natyre. Rrjetëzimi për ne është i rëndësishëm me të gjitha dinamikat që mbart. Ne gjithmonë kemi patur vizionin për të zgjeruar bashkëpunimet dhe organizatat partnere pavarësisht faktit nëse kjo lidhje do të jetë formale ose jo. Partnerët Shqipëri dhe të gjitha organizatat që zgjedhin të jenë pjesë e këtij programi shkëmbimi kontribuojnë jo vetëm në rrjetëzimin, por edhe krijimin e një mjedisi të hapur e të qëndrueshëm për OJF-të. Të gjitha organizatat që vizituan AWEN sollën një mësim e vlerë të shtuar më shumë me punën, sakrificat dhe angazhimin e tyre të përditshëm në tematika të ndryshme. Të gjitha ne tek AWEN, mësuam prej tyre!



INES LESKAJ

Drejtoreshë Ekzekutive, AWEN

DËSHMI
TË PËRFAQËSUESVE TË
INSTITUCIONEVE PRITËSE

KRISTINA VOKO

Drejtoreshë Ekzekutive, BIRN Shqipëri



Komunikimi me median është shumë i rëndësishëm për organizatat jofitimprurëse për të rritur jehonën e punës së tyre dhe për të qenë etik dhe të kujdesshëm me grupet e interesit, sidomos atyre që janë të marginalizuara. "Programi i Shkëmbimit të OJF-ve" mendon se ka qenë i rëndësishëm jo vetëm për përfaqësuesit e organizatave lokale për të shkëmbyer eksperiencën me organizatat simotra në qarqet e tjera të vendit, por për të gjithë ne, duke na rikujtuar sfidat me të cilat përballet shoqëria civile në vend dhe mbi të gjitha, vlerat që na bashkojnë të gjithëve.

I shoh me shumë vlerë organizime të tilla ndaj e pranova ftesën e Partnerëve Shqipëri. "Programi i Shkëmbimit të OJF-ve" shërbeu si medium diskutimi me një fokus të veçantë në të drejtat e njeriut dhe përpjekjet kundër diskriminimit. Përmes përpjekjeve bashkëpunuese dhe përvojave të ndara, u mundësua një dialog dhe mjedis mbështetës për organizatat që të thellojnë kuptimin e tyre për parimet e të drejtave të njeriut dhe strategjitë për të luftuar diskriminimin në mënyrë efektive. Ju uroj suksese organizatave në punën e tyre dhe shpresoj të përdoren sa më shumë mekanizmat.



DR. ROBERT GAJDA

Komisionieri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

DËSHMI
TË PËRFAQËSUESVE TË
INSTITUCIONEVE PRITËSE

BLERTA DRENOFCI (CANI)

Drejtoreshë Ekzekutive, FSHDP



Dilema më e madhe e një organizate jofitimprurëse është qëndrueshmëria. Shpesh për shkak të dinamikës së çështjeve sociale që synojmë të zgjidhim përballë përfituesish, në pamundësi financiare, organizatat hezitojnë ngritjen e shërbimeve me pagesë. Duke shkëmbyer idetë dhe përvojat me njëri-tjetrin, ne kuptojmë mundësitë që ofron mjedisi ynë, nxisim krijueshmërinë e njëri-tjetrit për zgjidhje inovatore, njohim më praktikisht rreziqet që duhet të manaxhojmë dhe mbi të gjitha bëhemi më të guximshëm në marrjen e iniciativave të reja për ngritjen e këtyre shërbimeve. Mirënjohëse Partnerëve Shqipëri që vazhdimisht punon për ndërtimin e një mjedisi, ku organizatat jofitimprurëse mund të forcohen, të rriten dhe veçanërisht për kënaqësinë për të qenë organizatë pritëse në "Programin e Shkëmbimit të OJF-ve". Ju mirëpresim sërish!

DËSHMI
TË PËRFAQËSUESVE TË
INSTITUCIONEVE PRITËSE

U ndjeva e vlerësuar të ndaj eksperiencat e organizatës ku unë punoj, me një grup të përkushtuar profesionistësh me pasion dhe dëshirën e mirë për të sjellë ndryshim në komunitetet dhe fushat në të cilat ata kishin fokusuar përpjekjet e tyre. Për mua ishte një ditë e ngjeshur jo vetëm shkëmbimi eksperiencash, por edhe shkëmbimi idesh dhe strategjish se si të orientonim sa më mirë problematikat me të cilat organizatat ishin ndeshur në punën e tyre. Pa dyshim, një program që i duhet sektorit tani dhe në vijim.



OREADA KITA

*Drejtoreshë Ekzekutive,
Qendra Jonathan*

